

PERSHKRIM I SISTEMIT TE ÇERTIFIKIMIT TE ALBINSPEKT

Përmbajtja

Të përgjithshme	2
5.1. Aplikimi	2
5.2. Inspektimi	3
5.2.1. Përgatitja e inspektimit	3
5.2.2. Inspektimi fillestar	3
5.2.3. Raporti i inspektimit	3
5.2.4. Aktivitetet e mbikëqyrjes / kontrollit	3
5.2.5. Kampionimi dhe analizimi	3
5.3. Çertifikimi	3
5.4. Çertifikata dhe logo e certifikimit	4
5.5. Rregullat për referencat ndaj certifikimit	4
5.5.1 Kërkesa të përgjithshme për referencat ndaj certifikimit	4
5.5.2 Përdorimi i logo-ve	4
5.6. Amendimet e Sistemit të Certifikimit të Albinspekt	6
5.7 Standartet	6
6. E drejta e apelimit	7

Të përgjithshme

Albinspekt është një trupë kontrolli shqiptare, e cila ofron shërbimin e inspektimit/auditit dhe çertifikimit sipas standarteve kombëtare e ndërkombëtare.

Albinspekt është një entitet ligjor i vetëfinancuar. Të ardhurat kryesore të aktivitetit vijnë nga ofrimi i shërbimeve të inspektim/certifikimit.

Akredituar sipas Normës Evropiane ISO 17065, Albinspekt është i listuar në Listën e Bashkimit Evropian për trupat e kontrollit si dhe nga Qeveria Zvicerane.

Aktiviteti i kontrollit dhe çertifikimit mbulon operatorët në Shqipëri, Kosovë si dhe dhe Maqedoni, Mal i Zi etj¹, të cilët zbatojnë standarte të çertifikimit të produktit ose të sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Sistemi i çertifikimit konsiston në auditimin dhe miratimin e menaxhimit të procesit të prodhimit dhe sistemit të kontrollit zbatuar nga operatori i cili dëshiron të përftojë produkte organike çertifikuara, ndjekur nga monitorimi konstant i konformitetit të procesit dhe analizave të kampioneve të marra në zonat e prodhimit/përpunimit ose të tregtimit.

Albinspekt ofron shërbime inspektimi/çertifikimi sipas:

- *Standartit Organik të Albinspekt (ekuivalent me Rregulloren e BE-së 834/2007 për bujqësinë organike, si dhe Rregullat përkatëse të zbatimit).*
- *Ligji Nr. 106/2016 "Për Prodhimin Biologjik, Etiketimin E Produkteve Biologjike Dhe Kontrollin e Tyre;*
- *Standarte private lokale;*
- *Standartit Hallall;*

Inspektim mbi standartet Ndërkombëtare/Private:

- *Bio Suisse- standard privat;*
- *Rregullorja e BE për bujqësinë organike 834/2007 dhe Rregullat përkatëse të zbatimit;*
- *NOP – Standarti Amerikan për prodhimin organik.*
- *Global G.A.P*

Skema e çertifikimit nga Albinspekt përfshin hapat e mëposhtëm.

5.1. Aplikimi

Operatori/klienti është i interesuar për shërbimet e Albinspekt dhe kontakton me Albinspekt nëpërmjet telefonit/e-mail/faqs së internetit:

Tel/ Fax:	+ 355 44806018
E-mail:	contact@albinspekt.com
Faqe interneti:	www.albinspekt.com

Albinspekt dërgon paketën e aplikimit dhe formularin e aplikimit. Në rastin e fermave të vogla Albinspekt do të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm me telefon ose në takime dhe paraqesë paketën e aplikimit jo më vonë se gjatë vizitës së parë të inspektimit.

Gjithashtu aplikuesi merr si shtesë edhe të gjithë informacionin dhe shpjegimet e kërkuara mbi aktivitetin e çertifikimit.

¹Gjithashtu shtete të tjera sipas EC 1235/2008, amendimi ne 2019

5.2. Inspektimi

Përshkruhet në procedurën 5.2.1 Inspektimi të Manualit të cilësisë së Albinspekt.

5.2.1. Përgatitja e inspektimit

Albinspekt do të caktojë një inspektor i cili nuk ka konflikt interesi me operatorin. Operatori mund të kundërshtojë përzgjedhjen e inspektorit në raste të justifikuara. Inspektori informon operatorin për datën e inspektimit dhe i kërkon të jetë prezent me dokumentet përkatëse.

5.2.2. Inspektimi fillestar

Inspektimi fillestar zhvillohet zakonisht 3 muaj pasi është marrë dosja complete e aplikimit, por jo më vonë se 4 muaj. Nëse inspektimi duhet të shtyhet për arsye teknike (p.sh nuk është sezoni i vegjetacionit) aplikuesi do të marrë një njoftim.

5.2.3. Raporti i inspektimit

Inspektori plotëson dhe përfundon raportin e inspektimit gjatë inspektimit, në njësi. Të gjitha rezultatet e nxjerra nga inspektimi dhe aspekte të veprimtarisë së njësisë përshkruhen në raportin e inspektimit dhe i komunikohen operatorit gjatë sesionit të mbylljes së inspektimit. Raporti i inspektimit nënshkruhet nga inspektori dhe klienti në fund të inspektimit. Me nënshkrimin e tij operatori vërteton se informacioni i dhënë nga ai gjatë inspektimit dhe i përmbledhur nga inspektori në raportin e inspektimit është korrekt dhe korrespondon me realitetin. Inspektori duhet t'i paraqesë operatorit një kopje të raportit të inspektimit.

5.2.4. Aktivitetet e mbikëqyrjes / kontrollit

Një inspektim i plotë fizik kryhet për të gjithë operatorët të paktën një herë në vit.

Gjatë inspektimeve, Operatori duhet të ofrojë bashkëpunimin me të madh stafit të caktuar nga Albinspekt. Nëse Operatori dështon në komunikimin e mungesës së tij në rastin e inspektimeve të njoftuara, ai do të mbartë koston e vizitës.

Inspektimet duhet të zhvillohen në prezencën e përgjegjësit të njësisë. Në mungesë të tij Albinspekt mund të pranojë një person të deleguar nga përgjegjësi i njësisë, nëse ai ka njohuri të mjaftueshme për njësinë dhe është autorizuar nga përgjegjësi për të ndjekur inspektimin, të lejojë hyrjen në të gjithë ndërmarrjen, të japë emrin e tij dhe të nënshkruajë raportin e inspektimit.

5.2.5. Kampionimi dhe analizimi

Albinspekt mund të marrë kandidate për të zbuluar ndotje të mundshme nga produkte të pa-autorizuara. Rezultatet pozitive të analizave do të konsiderohen në vendimin e certifikimit, dhe respektivisht mund të rezultojnë në ndryshimin statusit të certifikimit.

5.1.003 Dokumenti i tarifës për shërbimet, është përcaktuar se koston e analizave do të mbulojnë nga operatori. Mos pagesa e kësaj kostoje mund të çojë në tërheqjen e kontratës së certifikimit. Operatori do të njoftohet për laboratorin e zgjedhur dhe rezultatin e analizave.

5.3. Çertifikimi

Çertifikimi është një vendim i paanshëm i marrë nga personi përgjegjës brenda Albinspekt.

Funksioni i marrjen së vendimit të certifikimit është qartësisht i ndarë nga funksioni i inspektimit. Personat e përfshirë në inspektimin e një operatori nuk do të marrin pjesë në vendimin e certifikimit, dhe personeli vendimmarrës për certifikimin nuk do të jetë i përfshirë në inspektimet fizike të operatorëve. Vendimet e certifikimit nuk mund të delegohen palëve të nën-kontraktuara.

Albinspekt ka krijuar dhe dokumentuar procedura dhe rregulla për analizimin dhe përpunimin e çdo aplikimi për certifikim ose modifikim të kushteve të një certifikimi të dhënë më parë. Këto procedura përmbledhen në PR 5.3.1 Çertifikimi dhe në 5.3.001 Politika e sanksioneve, dhe mund të vihen në dispozicion sipas kërkesave.

Albinspekt cakton të paktën një person për rishikimin e informacionit dhe rezultateve të lidhura me inspektimin. Rishikimi duhet të kryhet nga persona të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në procesin e vlerësimit.

Rekomandimet për çertifikimin të dala nga rishikimi i inspektimit dokumentohen përveç rasteve kur rishikimi dhe çertifikimi kryhen nga i njëjti person.

5.4. Çertifikata dhe logo e certifikimit

Albinspekt lejon përdorimin e certifikatave dhe logos së tij në etiketa, reklama e broshura biznesi për operatorët e certifikuar. Operatorët e certifikuar mund të bëjnë deklarata për sa i përket certifikimit vetëm në lidhje me qëllimin e certifikimit.

Operatorët e certifikuar mund të përdorin logon e Albinspekt siç është përshkruar në QM 5.5 Rregullat për referencën ndaj certifikimit.

5.5. Rregullat për referencat ndaj certifikimit

5.5.1 Kërkesa të përgjithshme për referencat ndaj certifikimit

Operatorët janë të detyruar të:

- a) kryejnë referime ndaj certifikimit vetëm në respekt të qëllimit për të cilin u është dhënë ky certifikim;
- b) mos përdorin certifikimin e produktit të tyre në mënyrë të tillë që të diskreditojnë Albinspekt dhe nuk duhet të kryejnë pohime të cilat Albinspekt mund t'i konsiderojë si të pasakta ose paautorizuara;
- c) me pezullimin ose anulimin e certifikimit, të mos vazhdojnë përdorimin e materialeve promovionale të cilat kanë referenca ndaj këtij certifikimi dhe duhet t'i kthejë Albinspektit çfarëdolloj dokumenti certifikimi ashtu siç do t'i kërkohet nga vetë Albinspekt;
- d) përdorë certifikimin vetëm për të treguar se produktet e certifikuara janë konform me standartet e specifikuara;
- e) përpiqet të sigurojë se as certifikata, raporti ose pjesë të tyre nuk do të përdoren në mënyrë të pasaktë;
- f) Certifikata e produkteve organike mund të shfaqet në panairë, dyqane ose stenda për të shmangur konfuzionin e konsumatorit përkundrejt produkteve të pacertifikuara.
- g) përmbushë kërkesat e Albinspekt në kryerjen e referencës ndaj certifikimit të tij, në mediat e komunikimit të tilla si në broshura, dokumente apo reklama.
- h) Përdorin përbri shënimit apo logos së produktit të Albinspekt, kodin e akreditimit të Albinspekt (shih tabelën më poshtë).

5.5.2 Përdorimi i logo-ve

Albinspekt ushtron kontrollin e duhur mbi pronësinë, përdorimin dhe ekspozimin e logove të Albinspekt. Albinspekt nuk vendos asnjë tarifë për përdorimin e markave të tij të konformitetit.

a) Përdorimi i logos së EU

1. Klienti i certifikuar nga Albinspekt mund të përdorë në etiketimin e produkteve të tij të certifikuara sipas Standartit Organik të Albinspekt:
 - ✓ logon e Komunitetit të përmendur në Neni 57-58 e AOS për sa i përket ushqimit të parapaketuar;

- ✓ aty ku përdoret logo e Komunitetit, duhet të përdoret kodi "AL-BIO-139" për produktet e certifikuar të prodhuara në Shqipëri, dhe XK-BIO-139 për produktet e certifikuar të prodhuara në Kosovë menjëherë poshtë logos.
- ✓ aty ku përdoret logo e Komunitetit, duhet të përdoret një tregues i vendit në të cilin janë kultivuar lëndët e para bujqësore që përbëjnë produktin, siç përcaktohet më poshtë:
 - 'Bujqësi e BE-së', në rastet kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në BE,
 - 'Bujqësi jo e BE-së', në rastet kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në vendet e treta,
 - 'Bujqësi e BE-së / jo e BE-së', në rastet ku një pjesë e lëndëve të para bujqësore është kultivuar në Komunitet dhe një pjesë e tyre në një vend të tretë.

Këto tregues duhet të jenë në të njëjtin pozicion të dukshëm si edhe logo e Komunitetit.

Shembull I përdorimit të EU Logo:



AL-BIO-139
Non EU Agriculture

2. Indikacione të tjera që mund të përdoren

- ✓ Standardi për të cilin është certifikuar "**Standarti Organik i Albinspekt** (Ekuivalent me EEC Reg. 834/2007)".
- ✓ Termi "**Bio**" ose ekuivalent, për çdo përbërës të certifikuar.

b) Përdorimi i logos së produktit të Albinspekt



1. Klienti I certifikuar I Albinspekt mund të përdorë per Standartin Organik të Albinspekt ose Ligjin 106/2016, ne etiketimin e produkteve të tij të certifikuar:

- ✓ Logon e produktit të Albinspekt (si më lart) në produktet e paketuara
- ✓ Kjo logo mund të përdoret sipas specifikimeve të mëposhtme:
 - ngjyrat: Logo mund të jetë me ngjyrat siç është në origjinal: ngjyra ngjyra jeshile CMYK (C-50; M-42; Y-42; K-6); dhe llojin e shkrimit 'Arabic Typesetting'.
 - Klientët mund ta përdorin këtë logo edhe në formën një bardhe e zi, në varësi të vendosjes dhe sfondit në material, por shkrimi duhet të jetë i njëjtë.
 - vendin e vendosjes. Logo duhet të jetë e pozicionuar në një vend të dukshëm dhe të qartë;
 - sfondin ku do të përdoret. Logo mund të jetë edhe me sfond të tejdukshëm, në varësi të materialit mbi të cilin do të përdoret.

c) Përdorimi i logos institucionale të Albinspekt

Mund të përdoret nga Operatorët nën skemën e inspektim/certifikimit të Albinspekt, vetëm mbi materialet e reklamës, pa referenca ndaj produktit specifik subjekti certifikimit.

Të gjithë Operatorët që zbatojnë rregulloret ose standartet siç janë specifikuar në kontratën me klientin dhe janë subjekt i PR 5.2.1 Inspektimi të Albinspekt, dhe të cilët vetëm inspektohen (jo certifikohen) nga Albinspekt, janë të autorizuar për të përdorur mbi etiketat e produkteve të cilat janë subjekt inspektimi, shënimin "**Inspektuar nga Albinspekt**".

Të gjithë Operatorët që zbatojnë rregulloret ose standartet siç janë specifikuar në kontratën me klientin dhe janë subjekt i PR 5.3.1 Certifikimi të Albinspekt, janë të autorizuar të përdorin mbi etiketat e produkteve të cilat janë subjekt certifikimi, shënimin "**Çertifikuar nga Albinspekt**".

Në çdo rast, çdo etiketë apo referencë ndaj Certifikimit/Inspektimit të Albinspekt, duhet të miratohet paraprakisht përpara se të përdoret. Çdo referencë apo etiketë që nuk është miratuar nga Albinspekt dhe nuk përmbush kërkesat e mësipërme do të konsiderohet si e papërshtatshme dhe si jokonformitet.

5.6. Amendimet e Sistemit të Certifikimit të Albinspekt

Menaxheri i cilësisë është organi/autoriteti kompetent brenda Albinspekt për të amenduar Sistemin e Certifikimit dhe formuluar shpjegime për standartet specifike dhe dokumentet normative, përkundrejt të cilave Albinspekt certifikon produkte dhe/ose shërbime, për skema specifike certifikimi. Në rastet kur ky shpjegim kërkohet.

- a) Albinspekt mund ti modifikojë rregullat e Sistemit të Certifikimit të Albinspekt, si pasojë e rishikimeve pas auditeve të brendshme, ndryshimeve në politikën e certifikimit ose azhornimeve dhe amendimeve të normave relevante kombëtare, Evropiane ose të tjera.

Shembuj të këtyre ndryshimeve janë:

- Ndryshime në procedurën e aplikimit,
- Shtim të numrit të inspektimeve të palajmëruara.

Ndryshimet mund të rekomandohen nga punonjësit, anëtarët e komiteteve të brendshme, autoriteti kompetent ose nga palë të tjera të interesuara.

- b) Përpara se të merret vendimi përfundimtar për amendimin e rregullave të Sistemit të Certifikimit, Albinspekt do t'ju komunikojë palëve të interesuara nëpërmjet publikimit në internet ose mjete të tjera:
 - Datën kur këto amendime do të bëhen operative;
 - Rregullat e reja, masat korrektive që kërkohen dhe afatet kohore brenda të cilave duhet të zbatohen.
- c) MCI do të marrë parasysh pikëpamjet e shprehura nga palët e interesuara përpara se të marrë vendimin përfundimtar dhe të informojë operatorët për këtë vendim.
- d) Çdo Operator i cili mendon se e ka të pamundur plotësimin e rregullave të reja ose të zbatimit të masave korrektive të kërkuara, mund ta nisë dorëheqjen e tij me letër të regjistruar me kthim kërkesë, brenda datës së vendosur në komunikimin e përmendur në paragrafin b). Në këtë rast, atij do t'i ngarkohen vetëm sasi të e faturuara në datën e dorëheqjes. Nëse nuk është paraqitur asnjë letër dorëheqjeje nga Operatori brenda afatit të përmendur më sipër, amendimet janë të supozuara si të miratuara.
- e) Albinspekt verifikon nëse çdo operator ndërmerr përshtatjet e nevojshme brenda një afati kohor të arsyeshëm. Nëse masa korrektive nuk kryhen brenda afateve, certifikimi mund të pezullohet ose tërhiqet.
- f) MCI është gjithashtu përgjegjës edhe për të përfshirë korrektësisht ndryshimet në dokumentacionin e Albinspekt.

5.7 Standartet

Albinspekt i bazon aktivitetet e vlerësimit dhe të mbikëqyrjes në disa norma e rregullore, kombëtare si dhe ndërkombëtare.

MCI është i ngarkuar të kontrollojë rregullisht çdo amendim të standardeve të mësipërme dhe ndërmarrë veprimet pasuese atje ku është e nevojshme (p.sh informim të inspektorëve dhe operatorëve, përditësim i dokumentacionit). Për të qëndruar i azhornuar Albinspekt kontrollon rregullisht faqen respektive të internetit të institucioneve përkatëse dhe standarteve për të cilat operon, bëhet pjesë e shërbimeve të informimit dhe rrjeteve profesionale, dhe mban kontakte me autoritetet kompetente.

5.7.1 Standartet për certifikim

Për skemën e certifikimit aktivitetet e Albinspekt bazohen në Standartin AOS (ekuivalent me Rregulloren 834/2007 dhe rregullat përkatëse të zbatimit), Ligjin shqiptar mbi bujqësinë organike nr. 106/2016 dhe amendimet përkatëse.

Albinspekt zbaton një sistem certifikimi ekuivalent me Rregulloren e BE-së 834/2007 dhe rregullat përkatëse. '5.7.1 Standarti Organik i Albinspekt (Ekuivalent me Rregulloren e BE-së 834/2007)', formulon rregulla të detajuara për zbatimin e kërkesave të Rregullores së BE-së 834/2007 për certifikim nga Albinspekt. Këto rregulla kanë statusin e standarteve të detyrueshme për operatorët e certifikuar nga Albinspekt.

5.7.1 Standarti Organik i Albinspekt reflekton statusin aktual në shtetet ku Albinspekt ofron certifikimin e tij. Ato nuk duhet të shihen si një formulim final, por më tepër si një punë në progres për të kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm dhe adoptimin e praktikave organike në Evropën Juglindore sipas Rregullores së BE-së 834/2007. 5.7.1 Standardi Organik i Albinspekt është zhvilluar dhe miratuar sipas MC 5.6. Ky standart do të rishikohet rregullisht pas çdo rishikimi të Rregullores evropiane 834/2007 dhe rregullave përkatëse, por jo më vonë se në çdo dy vjet.

5.7.2 Standartet për inspektim

Për skemën e inspektimit aktivitetet e Albinspekt bazohen në Rregulloren e BE-së; Standartet private Bio Suisse; Rregulloren e Prodhimit Organik Kombëtar (NOP) SHBA; Global GAP etj.

6. E drejta e apelimt

Në rast se klienti nuk është dakort me vendimin e certifikimit ai/ajo ka të drejtën e apelimt pranë Albinspekt.

Albinspekt angazhohet të sigurojë një shërbim me cilësi të lartë për klientët, personelin dhe palët e tjera.

6.1 Apelime

i. Të përgjithshme

Albinspekt konsideron si "apelim" çdo lloj komunikimi nga klientët ose palë të tjera për kërkimin e një ndryshimi zyrtar në një vendim certifikimi, tërheqje apo pezullim certifikimi, të marrë nga Albinspekt.

Albinspekt trajton si apelime edhe ankesat, për zgjidhjen e të cilave nuk është rënë dakord midis ankuesit dhe Albinspekt.

Apelime trajtohen në rast se merren me shkrim:

- Me postë: 'Rr. Kavajes', Nd.132, Hy.9, Kati 8, Ap.43, Tiranë, Shqipëri.
- Me e-mail: contact@albinspekt.com.

ii. Trajtimi apelimeve

Për çdo apelim të marrë Albinspekt do të ndjekë procedurën e brendshme siç përcaktohet në PR 6.3.1 Apelime, ankesat dhe konfliktet dhe do të mbledhë informacionin/dokumentet relevante për trajtimin e apelimt. Vendimin përfundimtar për certifikimin merret nga Komiteti i Apelimeve.

Pasi KA ka marrë vendimin, dokumentet respektive (ku është relevante: certifikatën dhe letrën e certifikimit, informacion për vendimin e KA), i dërgohen palës apeluese.

Në rast se pala apeluese nuk është dakort me vendimin e marrë, ai/ajo mund t'a çojë çështjen në Gjykatën e Tiranës.